



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.13

Prishtinë, më 29.04.2015, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi, Teuta Haxhiu, Mufera Sinik dhe Jelena Bontiç

Pjesëmarrës të tjerë: Blendina Krasniqi- UNDP (praktikante), Isuf Koci-KKTR, Isa Vatovci-Kosova Sot, Drilon Asllani-Radio Dukagjini, Driton Selmanaj -KDI

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të dits;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.04.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Trashëgiminë Kulturore.
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22.04.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 22.04.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Trashëgiminë Kulturore.

Nait Hasani, tha se projektligji për Trashëgimi Kulturore me të gjitha vërejtjet që i ka, i plotëson kushtet për tu proceduar për lexim të parë në senacën plenare.

Salih Morina, tha se pajtohet që të procedohet projektligji, ai shtoi se gjatë fazes së amendamentimit duhet sqaruar nenin 29 paragrafi 2 që ka të bëjë me përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore, ka edhe disa nene që ka nevojë të riformulohen, por me organizimin e dëgjimit publik dhe ndihmen e organizatave ndërkombëtare dhe të OJQ-ve vendore shpresojmë të japim kontributin tonë pasi që kemi të bëjmë me një nder ligjet me rendësi të veçantë.

Jelena Bontiç, pajtohet me atë që ligji është i rendësisë së veçantë, që ka të bëjë me çështjet e trashëgimisë dhe si Komision duhet formuar grup punues për të shqyrtuar dhe amendamentuar.

Teuta Haxhiu, tha se i jap përkrahje në parim këtij projektligji dhe kur të fillojmë punën duhet të ndalemi në çdo nen dhe secili prej ne të jap kontributin e tij duke marrë parasysh edhe sygjerimet e ekspertëve.

Bekim Haxhiu, tha se deri më tash ajo që kemi parë nga ligji i mëparshëm është një përzierje e kompetencave, një dualizëm në mes të departamentit të Trashëgimisë Kulturore në kuadër të Ministrisë dhe Këshillit, ai theksoi se e mbështes këtë projektligj dhe duhet ti zgjidhim problemet në mënyrë ligjore dhe ta eliminojmë këtë dualizëm.

Shpejtim Bulliqi, tha se ky projektligj ka disa mangësi por në parim e përkrahi dhe pastaj mund ta shqyrtojmë.

Shukrije Bytyqi, tha se projektligjin e mbështes në parim edhe pse ka disa lëshime, përveç dualizimit në mes të Këshillit për Trashëgimi Kulturore dhe departamentit të Ministrisë kemi probleme edhe në shumë komuna për monumente të trashëgimisë kulturore.

Ismajl Kurteshi, tha se përveç çështjeve që u cekën për anëtarët e Këshillit të Trashëgimisë ka çështje të tjera shumë më të rëndësishme që duhet të shqyrtohen në hollësi sidomos neni 19 pika 13, ku disa zona historike kanë ligje të veqanta dhe kanë një trajtim të veçantë dhe ky ligj fare nuk ka ndikim në to, por ka edhe disa zona të tjera që nuk përmenden si ligje të veqanta dhe nuk trajtohen me këtë ligj.

Pas diskutimeve Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Miratohet në parim Projektligji Nr.05/L-26 për Trashëgiminë Kulturore.

Komisioni, Kuvendit ia paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet në parim, Projektligji Nr.05/L-26 për Trashëgiminë Kulturore.

4. Të ndryshme

Nait Hasani, lidhur me themelimin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj tha se duhet kërkuar nga Ministri i Arsimit dokumentacionin për vendimin e themelimit si dhe të proceduhet Statuti i këtij Universiteti në Kuvend për miratim.

Bekim Haxhiu, tha se në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar që ti kemi disa të dhëna për këtë Universitetin, si numrin e studentëve, hapsirën, stafin dhe planifikimet se si mendon të zhvillohet ky Universitet. Ai theksoi se asnjë nga Universitetet e krijuara ligjërisht nuk i përmbush kriteret më shumë se sa Fakulteti i Mjekësisë që të kalojë në një Universitet Mjekësor, Fakulteti i Mjekësisë e ka hapsirën dhe do të duhej të funksiononte në kuadër të Qendrës Klinike Universitare, kërkesa e mësimëdhënësve dërguar Ministrisë është e nënshkruar nga 256 prej tyre dhe kamë kërkuar nga dekani i Fakultetit që të njejtën dosje ta sjell edhe në Komision. Në vazhdim tha se duhet të mendohet për aspektin profesionale, edukative dhe nivelin e mësimit në këto Universitete, që të ruhet cilësia dhe të ketë sa më shumë mundësi për studentët.

Nait Hasani, propozoi që ti dërgohet një kërkesë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Administratës dhe Ministrisë së Arsimit për të mundësuar alokimin e buxhetit për financimin e tri shkollave, në Ferizaj, në Podujevë dhe në Prizren dhe për shkollën në Halabak të Podujevës e cila i zhvillon mësimet në baraka.

Salih Morina, tha se duhet të njoftojmë Ministrin e Financave, të tregojmë arsyen dhe shumën që kërkohet.

Ismajl Kurteshi, tha se pajtohet që të punohet me urgjencë për përfundimin e këtyre projekteve që kanë ngecur, si dhe të trajtohen të gjitha shkollat në mënyrë të njejtë sepse ka edhe disa shkolla të tjera baraka.

Shpejtim Bulliqi, tha se gjendja në shkollën në Halabak është shumë e rëndë.

Shukrije Bytyqi, lidhur me çështjen e mbajtjes së grevës së punëtorëve të arsimit tha se është për zbatimin e kontratës kolektive por jo të krijohet huti tek nxënësit dhe të krijohet një situatë jo e mirë. Ajo propozoi që të ftohet kryetari i sindikatës së arsimit për diskutim lidhur me këtë çështje.

Nait Hasani, tha se nga takimi me përfaqësuesit e sindikatës, kam kërkuar nga ta që të dalin në teren të shikojnë se sa mbahen orët nga mësimëdhënësit, a mbahen testet me rregull dhe sa janë të rregullt nxënësit në mësim.

Ismajl Kurteshi, tha se greva e krijuar nuk është e arsyeshme, ai shtoi se jam që ti përkrahim sindikatat por vetëm atëherë kur kanë të drejtë.

Shpejtim Bulliqi, tha se puna e sindikatës është që të marrin me seriozitet çështjet e mësimëdhënësve por të drejtat e tyre nuk mbrohen në këtë formë.

Bekim Haxhiu, tha se duhet ti bëjmë vërejtje ministrit të financave i cili nuk është dakorduar me kohë me mësimëdhënësit, të cilët kanë pasur informata që i'u është llogaritur përvoja e punës në

pagën bazë që e kanë pasur më herët dhe nuk i'u është llogaritur në këtë që e kanë tani, ai shtoi se nuk është në rregull që të luhet me dinjitetin e mësimëdhënësve dhe ti fusin në grev për 1 euro.

Teuta Haxhiu, tha se të diplomuarit që aplikojn për mësimëdhënës nëpër shkolla ankohen në drejtoritë komunale që pranojnë mësimëdhënës të kualifikuar nga kolegjet dhe kjo është në kundërshtim me ligjin për arsimin e lartë. Në vazhdim tha se Ministria edhe sot e kësaj dite nuk ndërhyjnë tek kolegji AAB, që e përdorë emërtimin Institucioni Universitar AAB dhe shumica e mësimëdhënësve kanë dal pikërishtë nga ky kolegji.

Nait Hasani, tha se ne kemi kërkuar nga ministri që të marr masa dhe në bazë të vendimit të tij është e pamundur që të pranohen mësimëdhënës që përfundojnë studimet në kolegje private, pa përfunduar edhe trajnime shtes.

Ismajl Kurteshi, tha se është detyrë e jona si Komision i Arsimit ti identifikojmë këto probleme, ti publikojmë dhe të pengojmë shkeljen e ligjit. Ne duhet ta përmbushim misionin në të cilin jemi, duhet të monitorojmë dhe publikojmë shkeljet të cilat bëhen.

Bekim Haxhiu, tha se detyra jonë si deputet është edhe aprovimi dhe monitorimi i ligjeve edhe i punës së Qeverisë dhe përderisa nuk ka një akt gjyqësor që dikush e ka shkelur ligjin dhe është dënuar për atë, nuk mund të themi se është duke u bërë shkelje.

Teuta Haxhiu, tha se kam listën nga AKA-ja se kush është kolegji dhe ky institucion bënë shkeljen e ligjit sepse bartë emërtimin Institucioni Universitar i arsimit të lartë dhe nga ky institucion kanë dal mësimëdhënës që nënkupton se ky institucion ka bërë falsikimi e diplomave.

Bekim Haxhiu, tha se nëse një student ka marrë diplomë në një kolegji privat dhe me të është punësuar, këtu nuk ka faj institucioni që ia ka lëshuar diplomën nëse ai është pranuar në punë.

Teuta Haxhiu, tha se në ligj shkruan që asnjë nga bartësit privat të arsimit të lartë nuk nxjerr mësimëdhënës.

Shukrije Bytyqi, tha se ne e kemi obligim ti përcjellim parregullsitë dhe nëse asnjë kolegji privat nuk përgatit mësimëdhënës atëherë nuk duhet të mashtrohen studentet nga këto kolegje. Ajo theksoi se në takimin që do ta kemi me ministrin për ligjin e maturës është mirë që ta ngrisim edhe çështjen e akreditimit sepse Kuvendi duhet ta bëjë përzgjedhjen drejtorit të AKA-së.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani